



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:063469

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05494099

KF.nr.119/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar-administrativ të paditësit-propozuesit “Auto Sallon Geti” SH.P.K me numër unik identifikues 811964198 dhe seli në rr.”11 Marsi”, Prelez i Muhaxherve, Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson L.M. avokat në Ferizaj, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas padisë së paditësit për anulim vendimi, objekt i kontestit- kundërvajtje doganore, vlera e kontestit 3,000.00 euro, dhe sipas propozimit - kërkesës së paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ - vendimit me nr. prot.01.3.2.2/26129 të datës 18.12.2023, jashtë seancës, me datë 25.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TERHEQUR padia dhe propozimi për caktimin e masës së përkohshme-shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e evidentuar me numër KF.nr.119/24 e paditësit “Auto Sallon Geti” Sh.P.K me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat L.M., për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

A r s y e t i m

Paditësi “Auto Sallon Geti “ Sh.P.K., përmes të autorizuarit të tij avokat L.M., ka ushtruar padi në këtë gjykatë, me të cilën ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Dogana e

Kosovës me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit prot. prot.01.3.2.2/26129 të datës 18.12.2023. Padiësi me padi, ka kërkuar edhe caktimin e masës së përkohshme për shtyrje të ekzekutimit të vendimit prot. prot.01.3.2.2/26129 të datës 18.12.2023 deri në përfundim të çështjes kryesore-padisë.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë dhe propozimit për caktimin e masës së përkohshme-shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ ka gjetur se padiësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore, prandaj gjykata me vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore KF.nr.119/24 të datës 26.02.2024 e ka obliguar padiësin që në afat prej 15 ditësh nga pranimi i kësaj vërejtje, të paguaj taksën gjyqësore për padi në shumë prej 50 €, dhe për propozimin-kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit taksën prej 20 €, ndërsa fletëpagesën t'ia dorëzoj gjykatës. I autorizuari i padiësit edhe pse e ka pranuar këtë vërejtje me datë 28.02.2024, siç vërtetohet nga fletëkthesa e postës e cila gjendet në shkresat e lëndës, nuk ka vepruar sipas vërejtjes dhe nuk e ka paguar taksën gjyqësore brenda afatit të caktuar prej 15 ditëve, por ajo nuk është paguar as deri në ditën e marrjes së këtij aktvendimi.

Pasojat juridike të mos pagesës së taksës gjyqësore janë të rregulluara në nenin 253 para. 5 të Ligjit për procedurën kontestimore, sipas të cilit *“Në qoftë se padiësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”*. Gjithashtu edhe neni 5 para. 5 nënpara 2 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësore ka përcaktuar se *“Pala duhet ta paguajë taksën në afatin e caktuar nga gjykatësi, gjegjësisht kryetari i trupit gjykues, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 dite. Nëse kjo taksë nuk paguhet në kohën e caktuar, gjykata zbaton procedurat e parapara, si ne vijim: (...) 5.5.2 Nëse taksë për padi, e përcaktuar sipas vlerës së kontestit në padi, nuk paguhet deri në datën përfundimtare, edhe pas pranimit të vërejtjes për pagesën e saj, në rastet kur nuk ekzistojnë kushtet për lirimin e palës nga detyrimi i pagesës, do të zbatohet neni 253 paragrafi 5 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ashtu që do të konstatohet se padia është tërhequr.*

Meqenëse paditësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore për padi dhe për kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit dhe në rastin konkret nuk ekzistojnë konditat për lirim nga pagimi i taksës gjyqësore, gjykata duke u bazuar në nenin 63 të LKA-së, nenin 253.5 të LPK-së dhe nenin 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, i Plotësuar ky me Udhëzimin Administrativ nr.02/2019, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.119/2024, datë 25.03.2024

G j y q t a r j a
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.